



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	12.10.2023	26.10.2023	2023/0769
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Ernest Kërqeli	16.10.2023		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.10.2023, OE **“Komtel Project Engineering SH.P.K.”**- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0769**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE **“Arianit R. Bytyqi”** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Zhvillimi i platformes per aplikime online (DIGIT-ARKEP)”** me nr. të prokurimit: **“UA/2016-23-7913-2-2-1”**, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **50,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Konsiderojmë se AK i ka shkelur:
Nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik (Tenderët jo-normalisht të ulët) dhe
Nenin 11 të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik (Tenderët jo-normalisht të ulët)

Nenin 10, paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik (Mjetet për promovimin e transparencës)

Nenin 7, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurimin Publik (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi)

Pretendimi i parë:

Shkelja e nenit 61 të LPP dhe shkelja e Nenit 11 Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik ('Udhëzuesi nr.001/2023')

Konstatohet se me dhënien e kontratës operatorit ekonomik sipas Tenderit, operatorit ekonomik “Arianit R. Bytyqi” (“OE”) përmes Njoftimit mbi Vendimin për dhënien e kontratës të AQP, të datës 19.09.2023 AQP (AK) janë shkelur në mënyrë flagrante dispozitat e nenit 61 LPP dhe nenit 11 të Udhëzuesit nr.001/2023, siç është shpjeguar më poshtë.

Së pari, nga tabela e ofertave të të gjithë tenderuesve është dukshme se OE i shpërblyer me kontratë ka çmim dukshëm më të ultë se të gjithë tenderuesit tjerë:

1	Arianit Bytyqi	22,900.00 Euro
2	Komtel	38,750.00 Euro
3	Tech Vision	42,850.00 Euro
4	Dataprognat	46,800.00 Euro
5	Inovativi	41,000.00 (tenderuesi i eliminuar - oferta nuk i mirret parasysh)
	Mesatarja	37,825.00

Këtu, vlenë të përmendet që vlera e parashikuar e kontratës (sipas Dosjes së Tenderit, FDT, pika 2.4) ka qenë EUR 50,000.00. Në këtë drejtim kujtojmë se neni 61.4 LPP, i jep të drejtë një autoriteti kontraktues që të refuzoj një tender jo-normalisht të ulët, pas konsiderimit të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga ai OE me tender jo-normalisht të ulët. Lidhur me këtë, Rregullorja nr.001/2022 për Prokurimin Publik (“RROUP”) përcakton që një autoritet kontraktues do të kërkojë me shkrim nga një OE që oferton me çmim jo-normalisht të ulët, *‘një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbatim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja “Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët”.*’ (neni 41.6 RROUP).

Për më shumë, një fakt i tillë fillimisht është vërejtur edhe nga AQP (AK), i cili me datë 25.08.2023, përmes platformës së e-prokurimit dhe Letrës Standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët për Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP) ka kërkuar nga OE deklaratën e përmendur më sipër. Përkatesisht, sipas bindjeve të vetë AQP konfirmuar me prova shkresore (pra Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët për Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP), e njëjta ka ardhur në përfundim që janë plotësuar kushtet e përcaktuara nga RROUP për lëshimin e Letrës Standarde, si në vijim (neni 41.3 RROUP):

1. Çmimi i ofruar nga OE ka qenë më shumë se 30 % më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm
2. Çmimi i ofruar nga OE ka qenë më shumë se 10 % më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët
3. Në këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar të paktën 3 tenderë.

Analiza e e tenderit jo-normalisht të ulët të OE sipas kritereve më lartë, konfirmon qartë se në rastin konkret, tenderi i OE në këtë aktivitet të prokurimit i përmbushë në mënyrë kumulative të gjitha kushtet më lartë, që *prima facie* të konsiderohet si tender jo-normalisht i ulët në kuptim të nenit 61 LPP dhe nenit 41 RROUP. Përkatësisht:

Kushti 1: Janë 4 oferta që e kanë plotësuar kriteret e eligjibilitetit - Plotësohet

Kushti 2: Mesatarja / 1.3 = $37,825.00 / 1.3 = 26,528.85 > 22,900.00$ - Plotësohet

Kushti 3: Oferta e dytë / 1.1 = $38,750.00 / 1.1 = 35,227.27 > 22,900.00$ – Plotësohet

Siç shpjegoam më lartë, të njëjtën gjetje dhe konstatim ka konfirmuar fillimisht edhe AK.

Në përgjigjen e tij (UniSoft_SqarimiTenderit_28.08.2023 (1).pdf), OE “Arianit R. Bytyqi” i jep disa sqarime, të cilat në rastin më të mirë janë jorelevante për tenderin në fjalë, ndërsa në rastin më të keq në kundërshtim me kërkesat e tenderit si dhe ato ligjore, ashtu siç është detajuar më poshtë. Komentet tona po i japim pranë secilit prej sqarimeve të OE më poshtë:

Pika 2 e Deklaratës së OE

‘2. Ne si kompani NTSH UNISOFT, kemi CMS Content Managment System të kompanisë. Dhe ne sa i përket pjesës së Webfaqes e kemi të gatëshme dhe vetëm kemi punë me implementimin e CMS në AK – AQP – DigiArkep.’

KOMENTI KOMTEL: Nga ky sqarim mund të nënkuptohet se OE i nevojitet më pak punë (dhe kosto) për ...”implementimin e CMS (së tij) në AK – AQP – DigiArkep”, e që njëkohësisht është në kundërshtim me kërkesën e AK:”OE duhet të paraqes një deklaratë të nënshkruar që platforma e ofruar nuk është Template i gatëshm dhe se CMS duhet të zhvillohet nga fillimi, i kostimizuar për nevojat e ARKEP-it, duke plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara teknike.

”

Çkado qoftë që OE ka deklaruar në deklaratën e vet në kuadër të tenderit lidhur me këtë çështje (e panjohur për Komtelin si sekret afarist), pamëdyshje bie poshtë pas sqarimit (diametralisht të kundërt me kërkesat e AK) që OE ka dhënë si arsyetim për çmim jo-normalisht të ultë.

Kërkojmë që paneli i OSHP-së të mos i pranon arsyetimet e OE “Arianit R. Bytyqi” të dhëna nën pikën 2 dhe të eliminon tenderin e OE si jo-normalisht të ultë, pasi të njëjtat janë në kundërshtim me përcaktimet e RROUP, sipas të cilave, gjatë vlerësimit nëse një tender është jo-normalisht i ulët, AK **duhet** të merr në konsideratë, ndër të tjerash, origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara. (neni 41.8 RROUP).

Pika 3 dhe 4 e Deklaratës së OE “Arianit R. Bytyqi (UNISOFT)”:

‘3. Ky projekt ka qenë i planifikuar nga AK – AQP ARKEP edhe në vitin 2021 me Nr. Prokurimi 21-8713-1-2-1 me titull zhvillimi i platformës për aplikim online (Digi-Arkep) vlera e planifikuar ka qenë 35,000.00 Euro, Ne si OE NTSH UNISOFT kemi aplikuar me çmimin prej 26,200.00 € me datë 23.12.2021 pos që Specifikacioni Teknik aneksi 1 është 100% i njëjti si pjesë përbërëse ka qenë edhe pjesa Harduerike (Serveri – Sipas Specifikacionit teknik të Aneksit 1).

4. Në aplikimin tonë si OE NTSH UNISOFT në AK – AQP ARKEP në vitin 2021 me Nr. Prokurimi 21-8713-1-2-1 me titull zhvillimi i platformës për aplikim online (Digi-Arkep)

vlera e planifikuar ka qenë 35,000.00 Euro, Ne si OE kemi dorëzuar ofertën me çmimin sipas Listës së çmimeve: 26,200.00 Euro,

Pozicioni 1. Softueri sipas Aneksit të specifikacionit teknik të detyrueshëm, copë, 1, Çmimi me TVSH: 14,700.00 €.

Pozicioni 2. Server sipas Aneksit të specifikacionit teknik të detyrueshëm, copë, 1, Çmimi me TVSH: 11,500.00 €.

Totali i përgjithshëm: 26,200.00 Euro’

KOMENTI KOMTEL: Përveç që është e paqartë se si OE “Arianit R. Bytyqi” mund ta konsideron shpërbërjen (në vija të trasha) të çmimit të tenderit të para dy viteve si përgjigje me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ultë...”, por për AK kursesi nuk mund të jetë relevante: Së pari, aktiviteti aktual i prokurimit nuk është vazhdimësi – në sensin ligjor dhe procedural – i aktivitetit të referuar të prokurimit të para dy viteve. Pa marrë parasysh faktin që teknologjia ndryshon dhe zhvillohet edhe për më pak se dy vite, e me to edhe kërkesat në treg, diçka që OE ishte dashur të ishte në dijeni, është shqetësuese që një Vendim i AK mbështetet në argumente të cilat nuk janë relevante dhe nuk aplikohen në këtë aktivitet të prokurimit. Sidoqoftë, vlenë të ceket se, as në tenderin e vitit 2021 nuk është dhënë ndonjë shpërbërje çmimi ku disa pozicione do të kushtonin më lirë apo falas në tenderin e vitit 2023 për shkak se OE e ka të gatshëm CMS dhe vetëm do ta implementon në ARKEP.

Konsiderojmë se oferta e OE Arianit R. Bytyqi nuk është reale duke pasur parasysh kërkesat e AK për zhvillimin e një sistemi të ri shumë kompleks veçmas për ARKEP dhe shprehimisht kundër implementimit të softuereve të gatshme të OE. Për zhvillimin dhe implementimin e një Sistemi prej fillimit si që është kërkuar për ARKEP-DIGIT duhet angazhuar një numër të konsiderueshëm të stafit me përvojë, kostoja e të cilit nuk është e mundur të përballohet me çmimin e ofruar nga OE Arianit R. Bytyqi duke marrë parasysh ngritjen e përgjithshme të çmimeve dhe ngritjen e çmimeve të shërbimeve në sektorin e TI / Zhvillimit të Softuerit. Këtë e vërteton edhe krahasimi me ofertat e tenderuesve tjerë ku del se vlera e ofruar është dukshëm nën kriteret e tenderit jo-normalisht të ulët.

Nga se u tha më lartë, kërkojmë nga paneli i OSHP që në pajtim me nenin 105 LPP dhe brenda kompetencave të tij: (a) të marrin çfarëdo masë tjetër të nevojshme dhe të përshtatshme për të verifikuar argumentet tona të paraqitura me këtë Ankesë, përfshirë mospranimin e arsytimit të OE, të dhëna nën pikat 3 dhe 4, si dhe të eliminojë tenderin e të njëjtit si jo-normalisht të ulët, (b) të japin urdhër për mënjanimin e nënshkrimit apo pezullimin e dhënies së kontratës, (c) të urdhërojnë AK të anulojnë apo revokojnë Vendimin për dhënien e kontratës dhe (d) t'i japin urdhër AK duke e detyruar të korrigjojë shkeljen (refuzimin e kërkesës për shqyrtim të Komtel si dhe OE-ve të tjera konkurruese) dhe/ose të parandalojë dëmtimin e mëtejshëm të Komtel dhe OE-ve të tjera konkurruese duke revokuar Vendimin për dhënien e Kontratës.

Pretendimi i dytë:

Shkelja e nenit 61 Tenderët jo-normalisht të ulët të LPP dhe shkelja e Nenit 11 Tenderët jo-normalisht të ulët të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik e të dyja në lidhje me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Pranimi (nga ana e AK) i sqarimit të OE të kundërt me kërkesat e AK-së të shpallura në dosjen e tenderit.

Në bazë të dokumentit “B41 Leter Standarde e kerkeses per informata mbi tendert jo-normalisht te ulet.Doc” që e kemi pruar nga AK (AQP), shihet se me datën 25.08.2023 Zyra e Prokurimit e AK (AQP) përmes platformës së e-prokurimit i ka dërguar OE (Ariant R. Bytyqi) Letrën Standarde të kërkesës për informata mbi tenderët jo-

normalisht të ulët për Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP).

Në dokumentin “UniSoft_SqarimiTenderit_28.08.2023 (1).pdf që e kemi pruar nga AK (AQP), në njërin nga arsyetimet për çmimin e ofruar OE thotë: “2. Ne si kompani NTSH UNISOFT, kemi CMS Content Managment System të kompanisë. Dhe ne sa i përket pjesës së Webfaqes e kemi të gatëshme dhe vetëm kemi punë me implementimin e CMS në AK – AQP – DigiArkep.

“

Komtel konsideron se sqarimi të cilin OE e ka ofruar në deklaratën e tij është në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit të AQP / ARKEP, sipas së cilës, duhet të zhvillohet një CMS prej fillimit i kustomizuar për ARKEP, të gjithë OE është dashur të paraqesin nga një deklaratë të posaçme të nënshkruar, si më poshtë:

“4.3. Kërkesa të përgjithshme lidhur me teknologjitë për zhvillim

..... “OE duhet të paraqes një deklaratë të nënshkruar që platforma e ofruar nuk është Template i gatshëm dhe se CMS duhet të zhvillohet nga fillimi, i kustomizuar për nevojat e ARKEP-it, duke plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara teknike.”.“

Në këtë drejtim, lidhur me dosjen e tenderit, neni 27 LPP përcakton që një autoritet kontraktues duhet të përpilojë një dosje të tenderit ‘që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshme ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues.’ Mu mbi këtë bazë – pra duke u mbështetur në kërkesat specifike të dosjes së tenderit të këtij aktiviteti të prokurimit, Komtel ka përpiluar dhe përgatitur ofertën e dorëzuar te AK.

Në anën tjetër, megjithë kundërshtinët eksplicite në mes të sqarimit të OE Arianit R. Bytyqi dhe kërkesave të lartëcekura të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme të dosjes së tenderit, AK (AQP / ARKEP) e trajton si tender jo-normalisht të ultë por nuk e refuzon tenderin e OE Arianit R. Bytyqi. Me këtë, AK (AQP / ARKEP) ia lehtëson kriteret njërit OE dhe i diskriminon OE tjerë me çka e then edhe paragrafin 1 dhe 2 të nenit 7 të LPP, përkatësisht një nga parimet themelore të prokurimit publik - barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi.

Nëse qëllimi i AK, gjatë procedurës së prokurimit, ka qenë të ndryshoj kërkesat e dosjes së tenderit, duke lejuar edhe CMS të gatshëm, atëherë, e njëjta është dashur ta ndjekë procedurën e paraparë me LPP, ku të gjithë OE trajtohen në mënyrë të barabartë, siç parashihet dhe kërkohet shprehimisht nga neni 34.5 LPP.

Pretendimi i tretë:

Shkelja e Nenit 10, paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik (Mjetet për promovimin e transparencës)

Me datën 22.09.2023 Komtel Project Engineering i ka bërë AQP (AK) kërkesën për qasjen në dokumentet e tenderit të OE.

Me datën 22.09.2023 AQP (AK) e ka pranuar kërkesën e Komtel Project Engineering për qasjen në dokumentet e tenderit të OE.

Me datën 22.09.2023 AQP ia ka dhënë ...”me USB (qip) OE Komtel Project Engineering dokumentet që ceken në fajllin “Pranimi_i_dokumenteve.pdf” (i bashkëngjitur).

1. Ofertën e OE te pastruar pasi që OE ka plotësuar Aneksin 3 KERKESE PER KON FIDENCIALITET

2. B41 Leter Standarde e kerkeses per informata mbiterenderet jo-normalisht te ulet.

3. Pergjigjen e OE-se si dhe

4. Raportin e Vleresimit te nenshkruar nga ZPP.

Komtel PE e sheh të rëndësishme të përmendët që nuk ka pranuar asnjë dokument nga të OE, nga AK (përpos Përgjigjes së OE-së) me arsyetimin se OE në kërkesën e tij për

konfidencialitet i ka paraqitur të gjitha dokumentet e tenderit të tij si sekret afarist. Komtel kërkon nga AK / OSHP që ta rivlerësojnë arsyeshmërinë e kërkesës së OE për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe të na mundësojnë qasjen në dokumentet e tenderit të OE me të cilat do mund të përgatitej një ankesë e bazuar në fakte e dokumente.

KRITERET PËR VLERËSIM

4.3. Kërkesa të përgjithshme lidhur me teknologjitë për zhvillim

Platforma duhet të zhvillohet duke përdorur teknologjitë, gjuhët programuese të cilat në të ardhmen lejojnë modifikim/shkallëzim (d.m.th., shtim të moduleve të reja). Ne si Autoritet Kontraktues nuk do të pranojmë oferta të cilat janë të bazuara në zgjidhje CMS (Content Management System) të gatshme me kod burimor të hapur (ang. open source) si WordPress apo Bootstrap ose diçka ngjashëm. OE duhet të paraqes një deklaratë të nënshkruar që platforma e ofruar nuk është Template i gatshëm dhe se CMS duhet të zhvillohet nga fillimi, i kostimizuuar për nevojat e ARKEP-it, duke plotësuar të gjitha kërkesat e parashtruara teknike. Për këto duhet dëshmi apo deklaratë me shkrim nga OE të vulosur për garantimin që CMS nuk do të jetë open source i gatshëm.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera –
Ministry of Finance, Labor and Transfers
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT

CENTRALNA AGJENCIA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹
Sipas Nenit 42.1 dhe 43.1 të Rregullave Nr. 001/2022 për Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)

Nr. i prokurimit	UA/2016-23-7913-2-2-1
------------------	-----------------------

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ²
1.	Arianit R. Bytyqi Rruga Raif Pollomi, L1/2, Nr.6, PRISHTINË 810201294	22,900.00 €
2.	Komtel Project Engineering SH.P.K. Agim Ramadani 34/7, PRISHTINË 811250836	38,750.00 €
3.	TECH VISION SH.P.K. Rruga Bardhyl Çaushi, Kompleksi Royal, Hyrja C15/16, kati 2, nr. 9, Prishtine 811500504	42,850.00 €
4.	"DataProgNet" SH.P.K. Rr. Qamil Ilazi, Nr.16, Ferizaj 810131318	46,800.00 €
5.	"Inovativi" Sh.p.k. Isa Kastrati, 81, Prishtina 600367818	41,000.00 €

Agjencia Qendrore e Prokurimit shpërblen me kontratë për Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP) Operatorin Ekonomik Arianit R. Bytyqi nga PRISHTINA në vlerë totale të ofertës prej 22,900.00 €

Data: 19.09.2023
Emri dhe mbiemri i ZPP: Blerina Haziraj

B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm ³

19.09.2023 Prishtinë

Autoriteti Kontraktues: Agjencia Qendrore e Prokurimit, Ndërtesa e Gërmisë kati V zyra A/504

Operatori Ekonomik: Komtel Project Engineering SH.P.K. Agim Ramadani 34/7, PRISHTINË
811250836

Operatori Ekonomik: TECH VISION SH.P.K. Rruga Bardhyl Çaushi, Kompleksi Royal, Hyrja C15/16,
kati 2, nr. 9, Prishtinë 811500504

Operatori Ekonomik: "DataProgNet" SH.P.K. Rr. Qamil Ilazi, Nr.16, Ferizaj; 810131318

Nr. i prokurimit	UA/2016-23-7913-2-2-1
------------------	-----------------------

Titulli: Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP),

I/e nderuar,

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj për **Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)** nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk qe tenderi me çmimin më të ulët në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata për **Zhvillimi i platformës për aplikime online (DIGIT-ARKEP)** i është dhënë Operatorit Ekonomik **Arianit R. Bytyqi**, nga **PRISHTINA**, për një shumë prej **22,900.00 €**.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t’i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Komtel Project Engineering SH.P.K.

Aktiviteti i prokurimit: “Zhvillimi i platformes per aplikime online (DIGIT-ARKEP)” me nr. të prokurimit: “UA/2016-23-7913-2-2-1”, iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit**, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 28.07.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 21.08.2023, Njoftimi mbi vendimi i AK-së është publikuar me datë 19.09.2023.

OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, me datë 06.10.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar ofertat konform LPP-së, dhe se ka shkelur nenet 7, 10, 61 i LPP-së si dhe neni 11 i udhëzuesit nr 001/2023 për PP.

I njëjti pretendon se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, për arsye se softueri nuk mund të ofrohet me çmimin e dhënë. Ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK lidhur me çmimet ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar, ku ky i fundit i sqaron dhe dokumenton arsyen, me të cilën përgjigje AK bindet dhe e merr të mirëqenë sqarimin, tutje si rrjedhojë, meqenëse aktiviteti i prokurimit si dhe natyra e pretendimeve kanë të bëjnë me teknologji informative, atëherë Ekspertja Shqyrtuese ka kërkuar që të angazhohet edhe një ekspert teknik i fushës.

Eksperti teknik, pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, pas shqyrtimit të ankesës, shihet se kemi të bëjmë me dy pretendime bazike të cilat përsëritën dhe ndërthuren në mes veti siç rëndom bëjnë OE gjatë shkresave të ankesave drejtuar OSHP-se.

Pretendimi që ka të bëjë me çështje teknike, specifikisht të softuerit, ***mund të përshkruhet si në vijim:*** Eksperti teknik, pas analizës dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës së dosjes së tenderit, Aneksit 1 të specifikimeve teknike të detyrueshme - zhvillimi i platformës për aplikacione online DIGITARKEP, me theks të veçantë në ofertën e paraqitur nga OE i rekomanduar, dëshmia dhe referencat e prezantuara në lidhje me projekte të ngjashme të kësaj natyre, deklarata nën betim se do të zhvillojë Sistemin e Menaxhimit të Përmbajtjes (CMS) dhe modulet sipas kërkesave të Drejtorisë Teknologjike (DT) dhe teknologjisë që do të përdoret në zhvillimin e këtyre

kërkesave të DT (12_UNISOFT_SpecifikimiTeknik_ARKEP v2.pdf), mund të konkludohet se, sipas dëshmive të prezantuara, nuk kemi të bëjmë me një CMS të gatshëm, por kemi të bëjmë me zhvillimin e moduleve nga fillimi, sipas kërkesave të ARKEP të përshkruara në DT, të cilat do të kustomizohen ose integrohen në CMS të zhvilluar nga OE i Rekomanduar. Teknologjia e propozuar për zhvillimin e moduleve të tilla është MVC5 bazuar në .NET 4.8, pra kemi të bëjmë me një ueb të zhvilluar në .NET dhe SQL Server.

Prandaj, në këtë çështje, kemi të bëjmë me një CMS të zhvilluar posaçërisht nga OE i Rekomanduar. Fakti që ky CMS është zhvilluar nga kompania (siç është përmendur në dokumentin sqarues të tenderit, në përputhje me kërkesat e datës 25 Gusht 2023 sa i përket kërkesës për çmim minimalisht të ultë) për projekte të ndryshme të implementuara në entitete të ndryshme të prezantuara në referencat e kërkuara, nuk duhet të jetë problematik. Përkundrazi, ky fakt është një faktor pozitiv në lidhje me performancën e projektit. Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, pretendimi i OE ankues kundër vendimit të AK në lidhje me këtë çështje **është i PA BAZUAR.**

Tutje, pretendimi i OE ankues lidhur me mosdhënien e qasjes, ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK të njëjtit i ka ofruar qasje në versionin e pastruar sipas dispozitave ligjore të LPP-së, për faktin se OE i rekomanduar ka nënshkruar kërkesën për konfidencialitet të të dhënave.

Përgjigja e AK-së lidhur me pretendimin:

Duke u bazuar në përgjigjen e KRPP-së pretendimi i juaj nuk qëndron.

Përgjigje për Pretendimi e tretë të OE-së Komtel Project Engineering: Shkelja e Nenit 10 Mjetet për promovimin e tansparencës,

Siç keni deklaruar dhe ju menjëherë pas kërkesës suaj për qasje me datë 22.09.2023, ne ju kemi ftuar po atë ditë që ta merrni qasjen. Pasi që OE ka pas të deklaruar si konfidencialitet të gjitha dokumentet e dorëzuara sipas kërkesës se Dosjes se Tenderit, AK duke u bazuar në nenin 11 të LPP-së paragrafi 4 juve i ‘u është ofruar versioni i pastruar i dokumenteve.

Duke vepruar sipas kërkesës se OE-së dhe duke respektuar nenin 11 të LPP-së paragrafi 3 citoj:

3. Autoriteti kontraktues mund t’i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

Juve ju është dhënë qasja në të gjitha dokumentet që nuk janë pjesë të këtyre neneve.

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, AQP si autoritet kontraktues në emër të Agjencisë së Pavarur të përfshirë në këtë aktivitet të prokurimit dhe në përputhje me nenin 108/A, paragrafi 10.1, konsideron se kërkesat e propozuar për shqyrtim janë të pabaza.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **“Komtel Project Engineering SH.P.K.”**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Zhvillimi i platformës per aplikime online (DIGIT-ARKEP)”** me numër të prokurimit: **“UA/2016-23-7913-2-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokrumit
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – Komtel Project Engineering SH.P.K.

Blerina Huruglica



Ernest Kërqeli

